



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA

GJAKOVA



Nr. 11262-3764

Datë: 12.03.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika (b) të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 86 paragrafi 1 ndërlidhur me nenin 65 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, Planin e Personelit 2024 me numër PP00001707, pas kërkesës/pëlqimit me numër 01-610/01-3104 të datës 01.03.2024 nga nëpunësi **Agron Shala** dhe **udhëheqësi i drejtpërdrejt i nëpunësit**, nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësi **Agron Shala**, i sistemuar në punë **Sekretar** në kuadër të SHFMU “Gjergj Fishta”, **transferohet** në pozitën e **Sekretarit** në SHFMU “Haxhi Hoti”.
2. Vendi i ri i punës është i të njëjtës kategori sikurse vendi i mëparshëm, **sipas koeficientit 5.6** (klasa E19 sipas Ligjit numër 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).
3. Nëpunësi fillon punën në pozitën e Sekretarit në SHFMU “Haxhi Hoti” nga data **02.04.2024**.
4. Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore brenda afateve ligjore duhet të bëjë përditësimet e nevojshme në kontratën e nëpunësit të shërbimit publik sipas nenit 82 paragrafi 3 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik.
5. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

A r s y e t i m

Kryetari i Komunës së Gjakovës me datë 01.03.2024 ka pranuar kërkesën numër 01-610/01-3104 nga nëpunësi Agron Shala përmes të cilës kërkonte që ti mundësohet transferimi i përhershëm në pozitën e Sekretarit në SHFMU “Haxhi Hoti”. Kërkesa e nëpunësit përmbante edhe pëlqimin e udhëheqësit të drejtpërdrejt të nëpunësit.

Nëpunësi publik mund të transferohet për interes të institucionit në mënyrë të përhershme në vend tjetër të punës për ushtrimin e funksioneve të njëjta ose të ndryshme, në të njëjtën kategori të shërbimit publik. Transferimi i përhershëm mund të bëhet në një njësi tjetër administrative në kuadër të institucionit të njëjtë ose në institucion tjetër të shërbimit publik. Përgatitja profesionale e nëpunësit që transferohet duhet të jetë në përputhje me kërkesat e pozitës në të cilën transferohet. Transferimi i nëpunësit publik brenda institucionit të njëjtë bëhet në pajtim me udhëheqësin e drejtpërdrejtë, udhëheqësin më të lartë administrativ dhe me pëlqimin e nëpunësit publik. Arsyetimi i vendimit të transferimit të përhershëm në interes të institucionit, përmban vlerësimin se nëpunësi plotëson kriteret e pozitës së punës ku transferohet. Ky vlerësim kryhet nga Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore e institucionit ku nëpunësi është i punësuar.

Pas shqyrtimit të kërkesës së nëpunësit, Kryetari i Komunës ka marr në konsideratë nevojat e kapaciteteve të Burimeve Njerëzore në Komunën e Gjakovës dhe në përputhje me Planin e Personelit 2024 me numër PP00001707 dhe pas vlerësimit nga Njësia për Menaxhimin e


Burimeve Njerezore permes te ciles konfirmohet se nepunesi i ploteson kriteret e pozites se punes ku transferohet, vendosi qe nepunesin Agron Shala ta transferoj duke e ngarkuar me detyrat e Sekretarit ne SHFMU "Haxhi Hoti".

Bazuar ne ate qe u tha me larte, u vendos si ne dispozitiv te ketij Vendimi.

KESHILLA JURIDIKE: Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit të Ankesave në Komunën e Gjakovës.

Vendimi iu dorëzohet:

- Njepunesit Agron Shala
- SHFMU "Gjergj Fishta"
- SHFMU "Haxhi Hoti"
- Drejtorise per Arsim
- Njesisë per Menaxhimin e Burimeve Njerezore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunes se Gjakoves

